



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 04.07.2024

Nr: 66

Ora: 11: 00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. GENTJAN FIQIRI MUÇA, ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 04.07.2024, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

- Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Gentjan Fiqiri Muça, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Palë të interesuara: Z. Gentjan Fiqiri Muça, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
- Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Data: 04.07.2024 Nr: 66
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z.Gentjan Fiqiri Muça, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Z. Gentjan Fiqiri Muça, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Për këtë kandidat në datën 29.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik. TR-PDSH-9691 unik. KQZ-ja bëri verifikimin “*prima facie*” dhe, pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtëm:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Gentjan Fiqiri Muça, nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë në sistem, rezulton i padënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Gentjan Fiqiri Muça, ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile rubrikën e emrit nga “Gentijan” në “Gentjan”.

II.

Në përfundim të procesit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 659, datë 7.06.2023, i ka dhënë mandatin z. Gentjan Fiqiri Muça, si anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë.

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Gentjan Fiqiri Muça, ku rezultoi se ka deklaruar:

Pyetjes 1” Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshuar rubrikën e emrit nga “Gentijan” në “Gentjan.”

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 4 “A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”; -Është marrë masë dëbimi në vitin 2011, nga autoritetet kufitare hungareze në Budapest për llogari të shtetit Gjerman.

Pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?” subjekti vetëdeklarues nuk ka shënuar as po as jo përbri përgjigjes, por ka plotësuar rubrikën më poshtë -Është marrë masë dëbimi në Gjermani për shkak të shkeljes së vizës studentore më datë 17.01.2008, vendim i zyrës së emigracionit, Bashkia Koln, Bonn.

Pyetjes 8 “‘A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?’, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Ka jetuar në Kosovë, për arsye punësimi, për periudhën tetor 2020 - korrik 2021.

-Ka jetuar në Torino Itali, për arsye shëndetësore, për periudhën maj 2017- korrik 2018.

-Ka jetuar në Bonn, Gjermani, për arsye Studimi, për periudhën tetor 2020- korrik 2021.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4262 prot., datë 26.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 661/35 prot.extra 23, datë 19.06.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Gentjan Fiqiri Muça. sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Rezultoni të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, rubrikën e emrit nga “Gentjan” në “Gentjan”, të deklaruar dhe në formular;
- Nuk rezultoni të jetë dënues për kryerjen e një veprë penale me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor;
- Nuk rezultoni i dënues me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezultoni të ketë qënë në hetim ose gjykim, për kryerjen e një veprë penale;
- Nuk rezultoni të ketë qënë i arrestuar apo ndaluar, nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e ndonjë veprë penale;
- Nuk rezultoni ti jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezultoni të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezultoni të jetë marrë ndonjëherë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj, në lidhje me veprimtari kriminale të kryer nga ky subjekt;
- Nuk rezultoni të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

II.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se subjekti vetëdeklarues z. Gentjan Fiqiri Muça, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Gentjan Fiqiri Muça, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të anëtarit.
2. Vazhdimin e mandatit të z. Gentjan Fiqiri Muça, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI